



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 561 prot

Roskovec , më 30.01 .2023

VENDIM

Nr. 3 datë 27/01 /2023

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË
TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE, NGA FONDI I KUSHTËZUAR
DERI 6% PËR BLOK-NDIHMËN PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Nenit 21 të Ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 1, të Kreut IV të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019“Për përcaktimin e procedurave,të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” i ndryshuar,Këshilli i Bashkisë

VENDOSI :

- Miratimin e kriterëve të mëposhtëme për trajtimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit,për vitin 2023.
- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike brënda 3 (tre) muajëve të fundit dhe nuk janë përzgjedhur fitues nga sistemi i pikëzimit.
- Familjet të cilat përzgjidhen për tu trajtuar me këtë fond duhet të jenë verifikuar paraprakisht nga zyra e ndihmës ekonomike.
- Familjet e përzgjedhura duhet të jenë familje në nevojë ,të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- Familjet ku kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për punë por për shkak të legjislacionit në fuqi nuk përfitojnë pagesën e paaftësisë.

- Familjet me prindër të divorcuar me të paktën një fëmijë në arsimin bazë ose të lartë.
 - Familjet me kryefamiljar vajzat nëna dhe gratë e veja.
 - Familjet të cilat nuk kanë anëtar përfitues të pensionit të pleqëris.
-
- Ngarkohet sektori i Shërbimit Social për zbatimin e këtij vendimi.
 - Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetar

Kadri Hyska

